



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

RREGULLORE

Nr. 26 datë 16.08.2012

Për

Përmbajtjen, formën dhe funksionimin e regjistrit elektronik të rrjeteve publike të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë

Miratuar me Vendimin nr. 2140, datë 16.08.2012 të Këshillit Drejtues të AKEP

I. DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Me kete rregullore percaktohet permbajtja, forma dhe funksionimi i regjistrit elektronik te rrjeteve publike te komunikimeve elektronike ne Republikën e Shqiperise, te cilen e administron AKEP.

Neni 2

Qellimi

Kjo rregullore ka per qellim te siguroje dhe te inkurajoje perdorimin e perbashket te objekteve dhe burimeve per te mbrojtur infrastrukturën e rrjeteve publike te komunikimeve elektronik edhe përmirësimin e shfrytezimit te kapaciteteve te rrjeteve publike te komunikimeve elektronike.

Neni 3

Baza Ligjore

AKEP nxjerr këtë Rregullore ne zbatim të germës nj) dhe p) të nenit 8, nenit 14, nenit 16, 20, 21, 92 dhe 137 të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”

Neni 4

Fusha e zbatimit

Dispozitat e kësaj Rregulloreje janë të detyrueshme për zbatim nga të gjithë sipërmarrësit që ofrojnë rrjete publike të komunikimeve elektronike ne Republikën e Shqiperise.

Neni 5

Perkufizime

Në këte rregullore, përveç perkufizimeve të ligjit për komunikime elektronike do të përdoren edhe perkufizimet dhe shpjegimet si me poshte:

- a) **Rruge Kabllore** eshte infrastruktura e rrjeteve publike te komunikimeve elektronike, e cila mund të formohet nga kanale (duct), shtresa mbrojtëse, lloje kabllosh me dimensione të ndryshme, materiale të ndryshme, shpejtësia e transmetimit të të

dhënave, puseta dhe / ose kabinete për lidhjen dhe pikat e ndarjes së kablllove. Kjo rrugë kabllore mund të vendoset nëntokë ose ajrore.

- b) **Infrastruktura nentokesore** është rrugë kabllore që është vendosur nën sipërfaqen e tokës në një thellësi të caktuar.
- c) **Infrastruktura ajrore** është rrugë kabllore që është vendosur mbi sipërfaqen e tokës në ajër.
- d) **Objektet e komunikimeve elektronike** janë të gjithë kabinetet e brendshme dhe të jashtme, rrugët kabllore dhe të gjitha objektet e komunikimeve elektronike, në të cilat janë vendosur pajisje aktive të komunikimeve elektronike por jo objektet administrative.
- e) **Radio transmetues** janë të gjitha sistemet e radio transmetuesve për të cilat AKEP ka lëshuar një Autorizim Individual për përdorimin e frekuencave.
- f) **Objektet administrative** janë objektet të përdorura nga operatorët e rrjeteve publike të komunikimeve elektronike për nevojat administrative, të biznesit dhe tregëtare ku nuk janë vendosur objektet e komunikimeve elektronike.
- g) **Regjistri Elektronik** është një sistem elektronik që përmban të dhëna për vendndodhjen gjeografike, kapacitetet e operatorëve të rrjetit publik të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë.

II. PERMBAJTJA DHE FORMA E REGJISTRIT ELEKTRONIK

Neni 6

Sigurimi, zhvillimi, administrimi dhe mirembajtja e regjistrit elektronik

- 1) AKEP siguron, zhvillon dhe miremban regjistrin elektronik.
- 2) AKEP mbulon koston e krijimit dhe funksionimit të regjistrit elektronik të rrjeteve publike të komunikimeve elektronike me fondin e vet.
- 3) Regjistri elektronik i rrjeteve publike të komunikimeve elektronike përbëhet nga baza hartografike e territorit të Republikës së Shqipërisë, të dhënat nga operatorët e rrjeteve të komunikimeve elektronike në përputhje me nenin 7 të kësaj rregullore dhe aplikimin që lejon dergimin e të dhënave, shpërndarjen dhe përpunimin e tyre.
- 4) AKEP përgatit udhëzues për të hyrë dhe përdorur të dhënat në regjistrin elektronik, sipas Aneks 3.

Neni 7

Permbajtja e regjistrimit elektronik

- 1) Regjistri elektronik përmban të dhëna për rrjetet publike të komunikimeve elektronike:
 - Objektet e komunikimeve elektronike;
 - Rruge kabllore;
 - Radio transmetues.

- 2) Të dhëna për objektet e komunikimeve elektronike:
 - Koordinatat gjeografike të vendndodhjes së objektit, komuna dhe vendi/ ose adresa;
 - Geosistemi koordinativ në të cilat koordinatat janë të specifikuar;
 - Shfaqje grafike me dimensionet e objekteve;
 - Detajet teknike të pajisjeve të instaluar duke përfshirë llojin, qëllim, materialin dhe kapacitetin.
 - Vleresim i kapacitetit të shfrytëzuar;

- 3) Të dhëna për rruge kabllore :
 - Koordinatat gjeografike për shtrirjen e rruges me detaje të pikave fundore dhe të dhëna për degezimet ose bashkimet me rruge të tjera, komunave, fshatrave dhe / ose adresat;
 - Shfaqje grafike e informacionit në lidhje me gjatësinë e rrugëve dhe vendosjen e tyre, informacion në lidhje me pozicionimin përgjatë rruges (nëntokesore/ajrore).
 - Geosistemi koordinativ në të cilat koordinatat janë të specifikuar;
 - Detajet teknike për linjat kabllore, duke përfshirë informacion në lidhje me kanale, llojet e kabllorëve të cilat përbëhet shtrirja, numri total i kabllorëve, kapaciteti i përgjithshëm i transmetimit;
 - Vendosja e pikave të lidhjes fizike dhe logjike;
 - Vleresim i kapacitetit të shfrytëzuar;

- 4) Të dhëna për radio transmetuesit:
 - Koordinatat gjeografike të vendndodhjes së radio transmetuesit, komuna dhe vendi/ ose adresë;
 - Geosistemi koordinativ në të cilat koordinatat janë të specifikuar;
 - Lartësia e antenës, të dhëna mbi drejtimet e rrezatimit, kapaciteti i transmetimit;
 - Detajet teknike të pajisjeve të instaluar duke përfshirë llojin e pajisjet dhe kapacitetin total;
 - Vleresimin e shfrytëzimit të kapacitetit shprehur në përqindje dhe fuqia e furnizimit;
 - Vleresim i kapacitetit të shfrytëzuar të radiotransmetuesve dhe shtyllës së antenave (statike dhe energjitik).

Neni 8

Disponueshmëria e të dhënave ne regjistrin elektronik nga operatorët e rrjeteve publike të komunikimeve elektronike

- 1) Operatorët e rrjeteve publike të komunikimeve elektronike kane akses online në regjistrin elektronik me te drejtat e mëposhtme:
 - Shfaqjen e siperfaqeve ne territorin e Republikës së Shqiperise me një shkallë maksimale;
 - Vizualizimin dhe disponueshmërinë e të dhënave të regjistrin elektronik per rrjetet publike të komunikimeve elektronike te ndertura që janë në pronesine e tyre, me detaje per koordinatat;
- 2) Operatorët e rrjeteve publike të komunikimeve elektronike duhet të paraqesin një kërkesë prane AKEP, ku specifikohet personi i autorizuar për akses në regjistrin elektronik, duke marrë përgjegjësi te plotë për veprimet e tyre dhe përdorimin e të dhënave.
- 3) Aksesin online ne të dhënat sigurohet nga AKEP per sejcilin operator te rrjetit publik të komunikimeve elektronike, per perdoruesin e autorizuar.

III. HEDHJA E TE DHENAVE NE REGJISTRIN ELEKTRONIK TE RRJETEVE PUBLIKETË KOMUNIKIMIVE ELEKTRONIKE

Neni 9

Mbledhja e te dhenave

- 1) Operatorët e rrjeteve publike të komunikimeve elektronike, kanë detyrimin të paraqesin të dhëna mbi rrjetet publike të komunikimeve elektronike të tyre sipas nenit 7 të kësaj Rregullore, ne AKEP, përmes mënyrave te meposhtme, duke përdorur nomenklaturën në përputhje me Aneksin 1 të kësaj Rregulloreje:
 - a) Dorëzimi nëpërmjet file-eve elektronike dhe të dhëna në formë shkresore, të cilat përmbajnë te dhëna mbi objektete e komunikimeve elektronike, rrugët kabllore dhe radio transmetuesit, ku file-t janë plotësisht në përputhje me regjistrin elektronik dhe në përputhje me aneksin 2 të kësaj rregulloreje.
 - b) Dorëzimi permes nderfaqes web.
- 2) File-t elektronike të pikes 1, germa a), te këtij neni duhet te dergohen të regjistruar në trasmetues mediatik, me dokument të nënshkruar nga një person përgjegjës i operatorëve te rrjeteve publike të komunikimeve elektronike, ku ne dokumentin e nenshkruar te jene te

vendosura të dhënat mbi file-t elektronike (emri, zgjerimi, data e krijimit, madhësia e çdo file te vecante, fjalëkalimin nese kerkohet, etj.).

- 3) Nepermjet file-eve elektronike, mund të dergohen të dhëna për një dhe / ose më shumë objekteve të komunikimeve elektronike, transmetues dhe / ose rrugë kabllore.
- 4) Nderfaqen web të pikes 1, germa b), te këtij neni e siguron AKEP për secilin operator te rrjeteve publike të komunikimeve elektronike ne Republiken e Shqiperise, me një (1) përdorues te autorizuar.
- 5) Çdo hedhje e te dhënave nëpërmjet ndërfaqes web, gjeneron nje log i cili do të mbetet si një rekord i përhershëm i hedhjes.
- 6) Përdoruesit e autorizuar permes ndërfaqes web duhet te hedhin të dhënat e tyre te rrjeteve publike të komunikimeve elektronike të tilla duke perfshire: të dhënat individuale për objektet e komunikimeve elektronike, radio transmetuesit dhe / ose rrugët kabllore, pas te cilës mund të shfaqen vizualisht dhe nuk do të jenë në dispozicion të publikut.
- 7) Të dhënat e hedhura permes nderfaqes web duhet te depozitohen ne AKEP shoqeruar me nje shkrese percjellese nga personi përgjegjës i rrjetit publik të komunikimeve elektronike, sipas Aneks 2.
- 8) Të dhënat e depozituara ne AKEP duhet të lejojnë personin përgjegjës në AKEP për të verifikuar të dhënat e hedhura nëpërmjet nderfaqes web, nga përdoruesi i autorizuar.
- 9) Në rast të mungesës së të dhënave per verifikim, personi pergjegjes ne AKEP mund te kërkojë nga operatori i rrjetit te dhena të tjera shtese në formë shkrese brenda 20 ditëve nga data e protokollimit te te dhënave në formë të shkrese prane AKEP.
- 10) Afati i fundit për dorëzimin e të dhënave nuk mund të tejkaloje 30 ditë nga data e përfundimit të ndërtimit të rrjeteve publike të komunikimeve elektronike.
- 11) Në qoftë se operatorët e rrjeteve publike të komunikimeve elektronike nuk do te perdorin me nje infrastrukture të caktuar, duhet të paraqesin njoftim me shkrim prane AKEP dhe fshirjen e kesaj infrastrukture nga regjistri elektronik.
- 12) Operatorët e rrjeteve publike të komunikimeve elektronike ne ofrimin e të dhënave ne AKEP duhet te percaktojne se cili prej informacioneve te paraqitura është konfidencial, në përputhje me legjislacionin ne fuqi.
- 13) Operatorët e rrjeteve publike të komunikimeve elektronike duhet te përditësojne të dhënat për kapacitet të shfrytëzuara të paktën një herë brenda 90 ditëve.

IV. TE DHENAT E RRJETEVE PUBLIKE TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE

Neni 10

Detyrat e operatorit të rrjeteve publike të komunikimeve elektronike

- 1) Çdo operator i rrjetit publik të komunikimeve elektronike duhet të zoterojë të dhëna për rrjetet publike të komunikimeve elektronike shkresore dhe / ose në formë elektronike për:
 - Objektet e komunikimeve elektronike;
 - Rrugët kabllore;
 - Transmetuesit radio.
- 2) Të dhënat mbi rrjetet publike të komunikimeve elektronike duhet të përmbajnë të pakten të dhënat e specifikuar sipas nenit 7 të kësaj rregulloreje.

Neni 11

Saktësia e të dhënave

- 1) Operatorët e rrjeteve publike të komunikimeve elektronike, që dorëzojnë të dhënat e rrjeteve publike të komunikimeve elektronike në AKEP dhe i pasqyrojnë këto të dhëna në regjistrin elektronik, përgjigjen plotësisht për saktësinë dhe besueshmërinë e informacionit.
- 2) AKEP me resurset e veta dhe / ose angazhimin e ekspertëve të jashtëm bën verifikimin e saktësisë së të dhënave duke përfshirë të dhënat mbi koordinatat gjeografike, kapacitetin dhe shfrytëzimin e rrjeteve publike të komunikimeve elektronike. Kostoja për përcaktimin e saktësisë së të dhënave, që rrjedh nga angazhimi i ekspertëve të jashtëm përballëhet nga AKEP. Në rastet ku vërtetohet se ka pasaktësi të të dhënave, operatori i cili ka në zotërim rrjetin publik të komunikimeve paguan shpenzimet.

V. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 12

Koha për krijimin dhe dorëzimin e të dhënave në AKEP

Operatorët e rrjeteve publike të komunikimeve elektronike kanë detyrimin për të krijuar të dhëna në formë shkresore dhe në formë elektronike për rrjete e veta të publike të komunikimeve elektronike, të pasqyrojnë ato në regjistrin elektronik dhe të paraqesin ato në formë shkresore dhe/ose formë elektronike në AKEP me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje.

Neni 13

Kundravajtjet administrative

Sipermarresit qe nuk zbatojne detyrimet e percaktuara ne kete rregullore do te denohen me gjobe bazuar ne nenin 137 të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 14

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi në datën e miratimit të saj me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP.

Neni 15

Publikimi

Kjo Rregullore, si dhe çdo ndryshim i saj, publikohet në faqen e internetit te AKEP me miratimin e saj.

ANEKS 1

Nomenklatura që do të përdoret nga operatorët e rrjeteve publike të komunikimeve elektronike për paraqitjen e te dhenave ne AKEP.

Objekti: Kabell Optik				
Tipi i Kabllit	Numri i fijeve optike	Mënyra e transmetimit	Vendosja	Shfrytezimi
OPT	XYZ numër i plotë	SM-single mode MM-multi mode	S – ajrore U- nëntokësore	%

Objekt: Kopje Bakri				
Tipi i Kabllit	Numri i kopjeve	Vendosja	Shenja shtese	Shfrytezimi
PSTN	XYZM numër i plotë	S – ajrore U- nëntokësore	SGN-kabell sinjali	%

Objekti: Kabell Koaksial			
Tipi i Kabllit	Trashësia e kabllit (mm)	Vendosja	Shfrytezimi
COAX		S – ajrore U- nëntokësore	%

Objekti: Kabell Ethernet			
Tipi i Kabllit	Trashësia e kabllit (mm)	Vendosja	Shfrytezimi
ETH		S – ajrore U- nëntokësore	%

Objekt: Kanal, Tubacion					
Shenja	Dimensioni i kanalit (Ømm, mm x mm)	Materiali (PVC, HDPE, ...)	Tipi i kabllit te instaluar në kanal	Kapacitete të lira	Shfrytezimi
DCT			O-Optik P-Bakri C-Koaksial		%

			H-Me shumë tipe		
--	--	--	-----------------	--	--

Objekt: Puseta				
Shenja	Dimensionet e pusetes (Ømm x mm, mm x mm x mm)	Materiali	Kapacitetetë lira	Shfrytezimi
SMH		CN- beton, PVC		%

Objekt: Kabineti				
Shenja	Dimensionet e kabinetit (Ømm x mm, mm x mm x mm)	Materiali	Kapacitete të lira	Shfrytezimi
SCB		M –metal, CN- beton, PVC;		%

Objekti: Radio				
Shenja	Shërbim Radiokomunikimi	Aplikimi	Fuqia (W)	Shfrytezimi
TX	MS	GSM UMTS WiMAX LTE		
	FS	PP PMP		
	BC	TV FM DVB-T		

Objekt: Bazamenti i Antenes						
Shenja	Tipi i Bazamentit (Grilë = M, Tub = P; Çimento =	Vendosje (Toke = F Siperfaqe = R)	Lartësia(M)	Pesha (kg)	Hapësira e lirë Meter ² /azimut	Shfrytezimi (kapacitetit i lire energjetik)

	CN)					
ANT						

OPT - Optik
 SM – Single Mode
 MM – Multi Mode
 PSTN - Public Switched Telephone Network
 ETH - Ethernet
 DCT – Duct
 SMH- Manhole
 PVC - Polyvinyl Chloride
 HDPE- High-density polyethylene
 SCB- Kabinet
 TX - Transmetues
 MS – Mobile Service
 FS – Fix Service
 BC – Broadcast Service
 GSM - Global System for Mobile Communications
 UMTS - Universal Mobile Telecommunications System
 WiMAX - Worldwide Interoperability for Microwave Access
 LTE – Long Term Evolution
 PP – Point to Point
 PMP – Point to Multi-Point
 TV - Televizion
 FM - Frequency Modulation
 DVB-T - Digital Video Broadcasting - Terrestrial
 ANT - Antena

Objekti: Kabell Optik:

Mënyra e transmetimit:

SM-single mode

- Fibra optike suporton vetem nje menyre drejtimi te polarizimit per gjatesi vale te caktuar.

MM-multi mode-

- Fibra optike suporton shperndarje shumerrugeshe te valeve.

Vendosja:

S – ajrore-

- Kur kablli eshte shtrire ne linja ajrore (mbi siperfaqen e tokes).

U- nëntokësor

- Kur kablli eshte shtrire ne linja nentokesore (nen siperfaqen e tokes).

Shfrytezimi-

Objekt: Kopje Bakri:

Shenja shtese

- Kjo e dhene perdoret per te cilesuar ndonje gje te vecante te kabllit qe e ben ate te dallueshem ose perdor ndonje shenje te fabrikuesit.

Objekt: Kanal, Tubacion:

Kapacitete të lira-

- Cdo tubacion me permasa te caktuara ka nje kapacitet te caktuar ne varesi edhe te permasava te tubacionit te shtrire. Ky kapacitet mund te mos jete shfrytezuuar i gjithe gjithi keshtu qe nje pjese e tij mund te jete e lire.

Shfrytezimi-

- Ne rast se poseiduesi i tubacionit mund te mos jete edhe poseidues i kabllit atehere do te kemi raportime te ndryshme kapacitetin e lire dhe per shfrytezimin sipas perkatesise prandaj dhe eshte perdorur raportimi edhe per kapacitetin e lire dhe per ate te shfrytezuuar..

Objekt: Puseta:

Kapacitete të lira-

- Cdo pusete me permasa te caktuara ka nje kapacitet te caktuar ne varesi edhe te permasava te tubacionit te shtrire. Ky kapacitet mund te mos jete shfrytezuuar i gjithe gjithi keshtu qe nje pjese e tij mund te jete e lire.

Shfrytezimi –

- Ne rast se poseiduesi i pusetes, mund te mos jete edhe poseidues i tubacionit, kabllit atehere do te kemi raportime te ndryshme per kapacitetin e lire dhe per shfrytezimin sipas perkatesise prandaj dhe eshte perdorur raportimi edhe per kapacitetin e lire dhe per ate te shfrytezuuar.

Objekt: Kabineti:

Kapacitete të lira-

- Cdo kabinet me permasa te caktuara ka nje kapacitet te caktuar. Ky kapacitet mund te mos jete shfrytezuuar i gjithe gjithi keshtu qe nje pjese e tij mund te jete e lire.

Shfrytezimi

- Nenkupton kapacitetin e shfrytezuuar referuar kapacitetit maksimal te tij per cdo raportues.

Objekti: Radio:

Shenja - përfaqësimi i një objekti që nënkupton një lidhje midis vetes dhe objektit të saj. Ne kete rast do te jete nje simbol per percaktimin e objektit radio.

Shërbim Radiokomunikimi – shërbim komunikimi nepermjet valeve radio I cili mund te jete Fiks, I Levizshem etj.

Aplikimi – Sistemi i perdorur per ofrimin e shërbimit (GSM/UMTS/ Lidhje Fikse etj)

Fuqia - Fuqia mesatare e furnizimit te antenës nga një transmetues (gjatë një intervali kohe mjaft të gjatë në krahasim me frekuencën më të ulët hasur gjate modulimit ne kushte normale operimi)Shfrytezimi- raporti midis kapacitetit te perdorur dhe kapaciteti te plote te transmetimit te objektit radio (kjo vlen vetem per ato raste kur kapaciteti I transmetuar nuk eshte sa kapaciteti maksimal I transmetimit te transmetuesit).

Objekt: Bazamenti i Antenes:

Shenja - përfaqësimi i një objekti që nënkupton një lidhje midis vetes dhe objektit të saj. Në këtë rast do të jetë një simbol për përcaktimin e bazamentit të antenës.

Tipi i Bazamentit -

Vendosje – koordinatat gjeografike të vendodhjes së objektit.

Lartësi – Lartësia nga niveli i tokës e objektit e shprehur në meter.

Pesha – Pesha e konstruksionit e shprehur në kilogram.

Hapësira e lirë dhe Shfrytëzimi (kapaciteti i lirë energjetik)

- Me termin shfrytëzim nënkuptohet raporti midis kapacitetit të përdorur dhe kapacitetit të plotë për secilin objekt të komunikimeve elektronike P.Sh.: Cdo kullë antene/antenash ka një kapacitet fizik për instalimin e antenave. P.sh. një kullë me lartësi x me permasa y me bazament me sipërfaqe z etj ka një kapacitet instalimi të caktuar, dmth mban një numër të caktuar antenash, që varet nga permaset, pesha e tyre, drejtimi i vendosjes etj. Këto të dhëna shërbejnë pikërisht për të vlerësuar kapacitetin e shfrytëzuar të një kulle, nëse është shfrytëzuar me kapacitet të plotë, nëse jo i plotë edhe sa kapacitet të lirë ka. I njëjti arsyetim është edhe për vlerësimin e kapacitetit të shfrytëzuar energjetik.

ANEKS 2

Formati i te dhenave

Dorezimi i te dhenave ne AKEP dhe importimi i tyre ne sistem do te realizohet me procedura te caktuara , neqoftese te dhenat pergatiten sipas formateve qe specifikohen me poshte:

Per objektet e tipit “point”:

a) Format i ne Microsoft Excel i tedhenave :

objekti: radio

	A	B	C	D	E	F	G	H
1	Gjeresi	Gjatesi	Shenja	Sherbim Radiokomunikimi	Aplikimi	Fuqia (W)	Shfrytezimi	Amplifikimi I antenes (dBi)
2	19°49'31.18"E	41°20'15.29"N	51	MS	GSM	15.85	100	16
3	19°49'31.18"E	41°20'15.29"N	52	MS	GSM	15.85	100	16
4	19°49'31.18"E	41°20'15.29"N	53	MS	GSM	15.85	100	16

objekti :baz_antene

	A	B	C	D	E	F	G	H	I	J
1	Gjeresi	Gjatesi	Numri i stacionit	Shenja	Tipi i bazamentit (Grile = M, Tub = P, Cimento =CN)	Vendosje (Toke =F, Cimento = R)	Lartesia (M)	Pesha (kg)	Hapesira e lire (Metri2/azimuth)	Shfrytezimi (kapaciteti i lire energjistik)
2	19°49'31.18"E	41°20'15.29"N	5	51	P	R	7	186.7	3.1	0.3
3	19°49'31.18"E	41°20'15.29"N	5	52	P	R	7	186.7	3.1	0.3
4	19°49'31.18"E	41°20'15.29"N	5	53	P	R	7	186.7	3.1	0.3


E njejta llogjike vlene dhe per objektet puseta dhe kabinet, pra krahas fushave te lartepemendura per keto objekte me lart, duhet te shtohen edhe dy kolona ne fleten e punes se Excel-it ku hidhen koordinatat per gjeresine gjeografike dhe gjatesine gjeografike.

b) Format i “shape files” i te dhenave :



Gjithashtu mund te implementohen ne system te dhenat e objekteve neqoftese ato parapergatiten ne formatin e njohur shapefiles.

Skedare template ne forme digjitale jane krijuar per secilin tip objekti:


-bazament antene




-kabell bakri




-kabell eternet




-kabell koaksial




-kabell optik




-kabinet




-kanal



-puseta



-radio



Keto template do te jene ne dispozicion te cdo sipermarresi ne forme elektronike.

c) Formati *.dwg i te dhenave:

Mund te implementohen ne sistem te dhenat e objekteve neqoftese ato parapergatiten ne formatin e njohur *.dwg, por eshte e nevojshme konvertimi i tyre ne shapefile ne menyre qe te mund te implementohen me sukses ne sistem.

Shenim 1:

Te dhenat e hartuar duhet te jene ne sistemin e projeksionit:UTM, zona 34 N , WGS84,

Shenim 2:

Çdo operator i rrjetit publik të komunikimeve elektronike, duhet të kryejë normalizimin e të dhënave të futura, në një nga formatet e siperpërmendura perpara dorezimit te tyre në AKEP, në përputhje me Ankesin 1 dhe kete Rregullore.

Normalizimi i të dhënave të paraqitura nga operatorët përfshin zbatimin e një nomenklature të vetme dhe përshkrim per:

- Emrat e objekteve;
- Vendndodhja;
- Përcaktimi i të dhënave përshkruese dhe cilësore në lloje të ndryshme të objekteve.
- Lidhje bashkuese per tipe te ndryshme te objektyeve Line dhe Polyline.

Pranimi i të dhënave te importuara në regjistrin elektronik dhe ne AKEP do te behet vetem duke plotësuar kushtet e mëposhtme:

- File-et duhet të paraqiten në AKEP të ruajtura në mediat e transmetimit fizik.
- File-et e kerkuar të përmbajnë kryesisht të dhëna për regjistrin elektronik, në përputhje me aneksin 1 dhe në disa nivele (shtresa) të ndara sipas llojit të objektit dhe/ose zonës.

Të gjitha objektet e çdo niveli janë të shënuara sipas nomenklaturës në përputhje me aneksin 1, 2 dhe sipas udhëzimeve në aneksin 3.

ANEKS 3

Guide per Operatoret

Programi i hartuar AKEP-GIS është program i mbështetur në teknologji "Open Source".

Në mënyrë që të ekzekutohet me sukses programi AKEP-GIS, përdoruesit duhet të kenë të instaluar në kompjuterat e tyre të pakten njërin nga browser-at si: Internet Explorer, Mozilla Firefox, Google Chrome.

Rekomandojmë që si shfletues të përdoren Mozilla Firefox ose Google Chrome, me përditësimet e herepashershme të tyre në varesi të zhvillimit të tyre.

Që të bëhet e mundur lidhja me programin është e nevojshme që përdoruesit e tij të jenë të pajisur me kredencialet e tyre (emër përdoruesi, fjalekalim).

Programi ofron mundësi që përdoruesit e sistemit të kenë aksesin e nevojshëm në sistem, në varesi të rolit që çdo përdoruesi do të caktohet në sistem.


Gjithashtu pjesë integrale e sistemit është edhe ndihma në përdorimin e tij, nëpërmjet tutorialeve të implementuara në të.

Pasi të kenë ekzekutuar njërin nga programet Mozilla Firefox apo Google Chrome, për të përdorur sistemin, përdoruesit duhet të shkruajnë URL-në e mëposhtme:

<http://95.107.162.147:8080/geoserver/www/index.html>


(Linku është subjekt ndryshimi dhe do tju bëhet me dije përdoruesve)

Me ekzekutimin e kësaj komande në ekranin e kompjuterit do të afishohet dritarja e mëposhtme e aplikimit:




Kliko mbi Butonin Login, i cili ndodhet ne kendin e djathte, lart

Afishohet dritarja e meposhtme ku shkruani perkatesisht emrin e perdoruesit dhe fjalekalimin perkates.




Automatikisht ne varesi te kategorise se perdoruesit te sistemit kalohet ne nje pamje tjeter te aplikimit , ku nder te tjera shtohen shtresat (layers-at) e destinuar per te.



Per te edituar shtresat perkatese , ne menyre qe te hidhet informacion i ri apo te redaktohen informacionet e hedhura me pare , duhet te kalohet ne dritaren e titulluar **Atlas Elektronik i AKEP**.

Pra, Kliko tab-in me emer Atlas Elektronik i AKEP:


Afishohet dritarja e meposhtme:



Editimi i i te dhenave:

Kliko mbi butonin Kerko dhe Shkarko te dhenat:

Paraqitet pamja e meposhtme:



Ne varesi te shreses qe duam te redaktojme (pra te shtojme apo te editojme informacionin) duhet bere zgjedhja e shtreses perkatese .

Per te realizuar kete vepohet ne kete menyre:


Ne pjesen e poshtme te dritare se paraqitur ku shkruhet **Kriteret e Kerkimit** , ne anen e djathte te etiketes **Layer** zgjidhni shtresen perkatese nga kutia **combo** djathtas saj pershembull **xxxxxxx (emer operatori)_antenat**:

Sistemi ofron shume mundesi mbi zgjedhjen e rekordeve per editim.

Filter mbi vendodhjen:

Sistemi afishon te gjitha rekordet perkatese te objekteve te shtreses perkatese qe ndodhen ne shtrirjen perkatese te ekranit


Atlasi Elektronik i AKEP



Mbivendësia e Hartes

- SHQIPERIA - Fshatrat
- SHQIPERIA - Komunitat
- Transporti**
 - SHQIPERIA - Rrugët Dytesore
 - SHQIPERIA - Rrugët Kombëtare
- Hidrografia**
- Mjedisi**
 - SHQIPERIA - Zonat e Mbrojtura
- Kabell Optik**
 - Linjat Optike
 - ITTEL - Linjat Optike
 - ALBTELEKOM - Linjat Optike
- Cift Bakri**
- Kabell Koaksial**
- Kabell Ethernet**
- Kanal (Duct)**

Info ATLASI



GOOGLE - Hibrid

Kriteret e Kerkimit

Layer: vodafone_antenat

Filter sipas vendndodhjes

Current extent: 19.4, 41.3, 19.7, 41.4

Filter sipas Attributeve

Rezultatet e Kerkimit (101 rekorde)

Shenja	Sherbimi	Aplikimi	Fuqia	Shfrytezimi	Amplifikimi
201	MS	GSM	12.59	100	17.54
202	MS	GSM	12.59	100	17.69
203	MS	GSM	12.59	100	17.54
205	MS	GSM	7.94	100	17.87
206	MS	GSM	7.94	100	17.95
207	MS	GSM	10	100	17.87
291	MS	GSM	12.59	100	16
292	MS	GSM	12.59	100	17.49

Filter sipas Attributeve:

Sistemi afishon te gjitha rekordet qe plotesojne kriterin apo kriteret perkatese.

Kriteret e Kerkimit

Layer: Shenja

Fil Sherbimi

Fuqia

Gjej Shfrytezimi

Amplifikimi

shto kusht

Rezult

Shenja

201

202

203

205

206

207


291

292

Pershembull zgjidhem antenat ne shtrirjen perkatese te ekrani dhe ku atributi

Fuqia ka vleren 12.59

Atlasi Elektronik i AKEP




Shtresat e Hartes | Legjenda e Hartes

Mbishtrësia të Atlasit

- Kufijte Administrative
- SHQIPERIA - Fshatrat
- SHQIPERIA - Komunitat
- Transporti
- SHQIPERIA - Rrugët Dytësore
- SHQIPERIA - Rrugët Kombëtare
- Hidrografia
- Mjedisit
- SHQIPERIA - Zonat e Mbrojtura
- Kabell Optik
- Linjat Optike
- ITEL - Linjat Optike
- ALBTELEKOM - Linjat Optike
- Cift Bakri
- Kabell Koaksial
- Kabell Ethernet
- Kanal (Duct)

Info ATLASI



Kerko dhe Shkarko te Dhena

GOOGLE - Hibrid

2 km
1 mi

1 : 108336

Kriteret e Kerkimit

Layer: vodafone_antenat

Filter sipas vendndodhjes

Filter sipas Attributeve

Gjej ndonje nga:

Fuqia = 12.59

shto kusht

Rezultatet e Kerkimit (888 rekorde)

Shernja	Sherbimi	Aplikimi	Fuqia	Shfrytezimi	Amplifikimi
61	MS	GSM	12.59	100	17.54
62	MS	GSM	12.59	100	17.49
63	MS	GSM	12.59	100	17.6
71	MS	GSM	12.59	100	15.2
72	MS	GSM	12.59	100	15.2
73	MS	GSM	12.59	100	15.2
104	MS	GSM	12.59	100	17
105	MS	GSM	12.59	100	18.2

Zgjidhni një rekord ne dritaren **Rezultatet e Kerkimit** dhe pastaj kliko mbi butonin **shfaq ne harte**


- Kliko mbi butonin **Edito Tipar Ekzistues** ne toolbar:
Afishohet një dritare e ngjashme si me poshte

Shtresat e Hartes | Legjenda e Hartes

Mbishtrësia të Atlasit

- Kufijte Administrative
- SHQIPERIA - Fshatrat
- SHQIPERIA - Komunitat
- Transporti
- SHQIPERIA - Rrugët Dytësore
- SHQIPERIA - Rrugët Kombëtare
- Hidrografia
- Mjedisit
- SHQIPERIA - Zonat e Mbrojtura
- Kabell Optik
- Linjat Optike
- ITEL - Linjat Optike
- ALBTELEKOM - Linjat Optike
- Cift Bakri
- Kabell Koaksial
- Kabell Ethernet
- Kanal (Duct)

Info ATLASI



Kerko dhe Shkarko te Dhena

GOOGLE - Hibrid

2 km
1 mi

1 : 108336

Kriteret e Kerkimit

Layer: vodafone_antenat

Filter sipas vendndodhjes

Filter sipas Attributeve

Gjej ndonje nga:

Fuqia = 12.59

shto kusht

Rezultatet e Kerkimit (888 rekorde)


Shernja	Sherbimi	Aplikimi	Fuqia	Shfrytezimi	Amplifikimi
482	MS	GSM	12.59	100	17.6
483	MS	GSM	12.59	100	17.69
491	MS	GSM	12.59	100	17.6
492	MS	GSM	12.59	100	17.6
493	MS	GSM	12.59	100	17
494	MS	GSM	12.59	100	17.49
521	MS	GSM	12.59	100	17
522	MS	GSM	12.59	100	17

Mund te editoni fushat perkatese duke klikuar mbi buton ndrysho te dritares se paraqitur dhe pastaj kliko butonin **Save** per te ruajtur ose **Cancel** per te mos bere ndryshime.

Per te fshire një tipar te caktuar duhet te klikoni mbi butonin **Fshi**

Procedura per te shtuar **Tipar te ri** realizohet duke klikuar mbi butonin **Krijo Tipar te Ri** qe gjendet ne **Toolbar**.

Afishohet dritare si me poshte:



Plotesoni fushat perkatese me informacionin e duhur.

Formati i te dhenave:

Ne sistem eshte parashikuar qe te implementohen te dhena per 9 objekte te ndryshme.

Pra objektet ndahen ne 2 kategori:

- objektete te tipit point
- dhe objektet te tipit polyline










Ne objektet e tipit **polyline** perfshihen:

- kab_bakri
- kab_ethernet
- kab_koaksial
- kab_optik
- kanal

Ne objektet e tipit **point** perfshihen:

- radio
- baz_antene
- pusea
- kabinet

Emertimi i objekteve ne sistem dio te jete si me poshte:

-  baz_antene
-  kab_bakri
-  kab_ethernet
-  kab_koaksial
-  kab_optik
-  kabinet
-  kanal
-  puseta
-  radio

Importimi i te dhenave ne sistem mund te realizohet me procedura te caktuara , neqoftese te dhenat pergatiten sipas formateve qe po specifikohen me poshte:

Per objektet e tipit point:

1-Formati ne Microsoft Excel i te dhenave :

objekti: radio

	A	B	C	D	E	F	G	H
1	Gjeresi	Gjatesi	Shenja	Sherbim Radiokomunikimi	Aplikimi	Fuqia (W)	Shfrytezimi	Amplifikimi I antenes (dBi)
2	19°49'31.18"E	41°20'15.29"N	51	MS	GSM	15.85	100	16
3	19°49'31.18"E	41°20'15.29"N	52	MS	GSM	15.85	100	16
4	19°49'31.18"E	41°20'15.29"N	53	MS	GSM	15.85	100	16

objekti : baz_antene

	A	B	C	D	E	F	G	H	I	J
1	Gjeresi	Gjatesi	Numri i stacionit	Shenja	Tipi i bazamentit (Grile = M, Tub = P, Cimento =CN)	Vendosje (Toke =F, Cimento = R)	Lartesia (M)	Pesha (kg)	Hapesira e lire (Metri2/azimuth)	Shfrytezimi (kapaciteti i lire energjitik)
2	19°49'31.18"E	41°20'15.29"N	5	51	P	R	7	186.7	3.1	0.3
3	19°49'31.18"E	41°20'15.29"N	5	52	P	R	7	186.7	3.1	0.3
4	19°49'31.18"E	41°20'15.29"N	5	53	P	R	7	186.7	3.1	0.3

E njeta llogjike vlen edhe per objektet puseta dhe kabinet, pra krahas fushave te lartepemendura per keto objekte me lart, duhet te shtohen edhe dy kolona ne fleten e punes se Excel-it ku hidhen koordinatat per gjeresine gjeografike dhe gjatesine gjeografike.

2 -Formati shapfiles i te dhenave :

Gjithashtu mund te implementohen ne sistem te dhenat e objekteve neqoftese ato parapergatiten ne formatin e njohur shapfiles.

- i. Skedare template ne forme dixhitale jane krijuar per secilin tip objekti.
- ii. Keto do ju shperndahen secilit operator ne forme elektronike.

3 -Formati *.dwg i te dhenave :

Mund te implementohen ne sistem te dhenat e objekteve neqoftese ato parapergatiten ne formatin e njohur *.dwg, por eshte e nevojshme konvertimi i tyre ne shpefile ne menyre qe te mund te implementohen me sukses ne sistem.

Qe te mund te realizohet me sukses, ne kete rast duhet bashkepunim me implementuesit e sistemit.

Shenim 1:

Te dhenat e hartuar duhet te jene ne sistemin e projeksionit:

UTM, zona 34 N , WGS84,